



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”  
Fakulteti i Edukimit**

**Programi i studimit:  
Master i Pedagogjisë për Shkollat Profesionale**

*Niveli i studimeve:*  
Master

*Numri i kredive:*  
120 ECTS

*Akredituar për periudhën:*  
1 Tetor 2016- 30 Shtator 2019

*Hartimi i këtyre materialeve është bërë me ndihmën e projektit "Modernizimi i Shkollimit të Mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës, nr. 544023" financuar nga Bashkimi Europian.*

The European Commission support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents which reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.

## **PËRMBAJTJA:**

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	4
2. REZULTATET E PRITURA.....	6
3. PASQYRA E PROGRAMIT: Master i Pedagogjisë për Shkolla Profesionale .....	7
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS .....	9

## 1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi dhe profili i programit Master i Pedagogjisë për Shkolla Profesionale është aftësimi i mësimitdhënësve për shkollat e mesme të larta profesionale në Kosovë. Ky program iu dedikohet mësimitdhënësve, të cilët aktualisht janë në procesin mësuesor dhe iu mungon komponenti profesional, si dhe ata që duan të përcaktohen për mësimitdhënie në shkollat e mesme të larta profesionale dhe që kanë përfunduar cilindo nga fakultetet akademike trevjeçare.

### **Kompetencat bazë të programit**

Kompetencat bazë të këtij program janë punuar në mënyrë konsultative dhe do të shërbejnë për definimin e rezultateve të pritura për programin si dhe do të përcaktojnë kurset që do të përfshihen brenda këtij programi. Në definimin e këtyre kompetencave është konsultuar edhe dokumenti i Komisionit Evropian “Parimet dhe kompetencat e përbashkëta për mësimitdhënës”, duke theksuar 4 kompetencat themelore: profesion i mirëkualifikuar; profesion që vendoset në kontekst të mësimit gjatë gjithë jetës; një profesion mobil; profesion i bazuar në partneritet.

Kompetencat e theksuara për këtë program janë vendosur si bazë mbi të cilën janë specifikuar rezultatet e pritura të programit dhe përmbajtja e programit.

### ***A: Legjislacioni:***

#### **Kompetencat e përgjithshme**

*Të dijë për dhe të implementojë legjislacionin dhe politikat arsimore.* Studenti të njohë sistemin arsimor në Kosovë, të kuptojë politikat arsimore të sistemit parauniversitar dhe të njihet me dokumentacionin ekzistues që lidhet me politikat e arsimit parauniversitar në vend (ligjet, Udhëzimet Administrative etj).

*Zbatimi i kurrikulave.* Studenti të jetë në gjendje të njohë Kornizën Kurrikulare të Kosovës dhe Kurrikulës Bërthamë. Të arrijë të kuptojë fushat dhe kompetencat e kërkuara në dokument si dhe të ketë shkathtësi për zbatimin e kurrikulës për nivelin e Arsimit Profesional

### ***B: Mësimitdhënie dhe nxënia:***

#### **Kompetencat e përgjithshme**

*Njohuri për procesin e mësimitdhënies dhe nxënies.* Studenti të njihet me teorinë bashkëkohore të mësimitdhënies, të kuptojë dhe zbatojë mësimitdhënien e bazuar në qasje të integruar, qasje të diferencuar, me ç’rast përfshihet edhe plani individual. Të jetë në gjendje të bëjë përzgjedhjen e metodave të përshtatshme dhe adekuate për temat dhe modulet përkatëse. Të njohë rëndësinë e procesit të vlerësimit dhe vetëvlerësimit, të jetë në gjendje të hartojë instrumente për vlerësim.

Të ketë shkathtësi për menaxhimin e klasës si dhe punë të pavarur hulumtuese. Të kuptojë punën e vet dhe të orientohet drejt zhvillimit të vazhdueshëm.

***Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për nxënie*** Studenti të jetë në gjendje të njohë personalitetin e nxënësve dhe të krijojë mjedis të përshtatshëm për mësim të suksesshëm. Të krijojë relacione komunikuese, interaktive, ndërkulturore, ndërpersonale, ndër gjinore, etj. Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për nxënie nënkupton edhe aftësinë për të krijuar situata dhe ambiente në të cilat secili nxënës ndihet komod për të marrë pjesë në aktivitete mësimore.

### ***C: Zhvillimi i vazhdueshëm profesional***

#### **Kompetencat e përgjithshme**

***Mësimi gjatë gjithë jetës.*** Studenti të krijojë shkathtësi për vetëvlerësim profesional; të ketë shkathtësi analitike dhe reflektive; të kuptojë rëndësinë e orientimit në karrierë, në mënyrë që t'u ndihmojë nxënësve në përzgjedhjen e profesionit të ardhshëm; të ketë shkathtësi të përdorimit të teknologjive të reja dhe të jetë inovativ.

***Ndërmarrësia*** Studenti të zhvillojë shkathtësi menaxheriale; të krijojë plan të biznesit për hartimin dhe zhvillimin e projekteve; të njohë rëndësinë e ruajtjes së ambientit dhe të zhvillojë idetë për edukimin e qëndrueshëm dhe ndërmarrësinë.

#### ***D: Bashkëpunimi***

#### **Kompetencat e përgjithshme**

***Lidhja me tregun e punës.*** Studenti të krijojë shkathtësi komunikimi dhe bashkëpunimi brenda dhe jashtë shkollës. Të krijojë shkathtësi për motivimin, nxitjen e bizneseve vendore dhe regjionale, përmes së cilës arrihen urat e bashkëpunimit me tregun e punës dhe zhvillimi i projekteve zhvillimore me ndërmarrjet dhe asociacionet biznesore.

***Rrjetëzimi.*** Studenti të krijojë rrjete me partnerët socialë (familjen, komunitetin, tregun e punës). Të ndajë informacionin dhe përvojën e tij me të tjerët. Të bëjë identifikimin e nevojave të mjedisit dhe shoqërisë në përgjithësi, në veçanti të identifikojë nevojat e tregut të punës dhe përfshirjen e tyre në arsimin dhe aftësimin profesional.

## 2. REZULTATET E PRITURA

Me përfundimin e këtij program studentët do të jenë në gjendje:

- Të analizojnë në mënyrë kritike lidhjen e arsimit dhe aftësimit profesional me tregun e punës dhe kërkesat e së ardhmes.
- Të shqyrtojnë në mënyrë kritike dhe kontribuojnë në proceset e zhvillimit të kurrikulës nëpërmjet angazhimit në aktivitetet profesionale dhe hulumtimeve në fushën e edukimit;
- Të krijojnë mjedis të përshtatshëm të nxënësve për të gjithë nxënësit, bazuar në të kuptuarit e raporteve midis teorive pedagogjike dhe praktikës së mësimdhënies.
- Të zhvillojnë të menduarit kritik dhe kreativ dhe të aftësohen për zbatimin praktik të teorive të ndryshme të të mësuarit dhe të përdorimit të burimeve arsimore duke përfshirë përdorimin e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit.
- Të zhvillojnë njohje të thellë dhe sistematike të koncepteve, si p.sh: gjithëpërfshirja, nxënësit me nevoja të veçanta (duke përfshirë edhe nxënësit e talentuar), barazia gjinore, etj., të shqyrtuara nga perspektiva të ndryshme.
- Të demonstrojnë të kuptuarit dhe aftësi për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin efektiv të përmbajtjeve nga lëndët profesionale nëpërmjet zbatimit të strategjive bashkëkohore të mësimdhënies.
- Të demonstrojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive në klasë dhe jashtë saj, me nxënësit, prindërit, kolegët, komunitetin dhe tregun e punës në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional.
- Të ndërliqhin njohuritë mbi legjislacionin dhe politikat arsimore të vendit me praktikën e tyre personale dhe zhvillimin e tyre profesional.
- Të zhvillojnë idetë për rëndësinë e ngritjes së vazhdueshme profesionale dhe të orientojnë nxënësit në krijimin e koncepteve për ndërmarrësi.

### 3. PASQYRA E PROGRAMIT: Master i Pedagogjisë për Shkolla Profesionale

#### VITI I PARË

##### SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Edukimi dhe shoqëria	O	3+1	6
2.	Psikologji e edukimit	O	2+2	6
3.	Politikat arsimore dhe legjislacioni	O	3+0	6
4.	Teoria e mësimdhënies dhe mësimnxënies	O	3+1	6
5.	Metodat e hulumtimit në arsim	O	2+2	6
<b>Gjithsej</b>			<b>13+6</b>	<b>30</b>

##### SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Zhvillimi i kurrikulave në AAP	O	2+1	5
2.	Vlerësimi në arsim	O	2+1	5
3.	Praktika pedagogjike I	O		10
4.	Strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies	O	2+1	5
5.	1. Mjedisi i punës i mësimdhënësit 2.Kulturë e komunikimit dhe shkathtësitë komunikuese	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>8+4</b>	<b>30</b>

## VITI I DYTË

### SEMESTRI III

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Edukimi për karrierë dhe planifikimi	O	2+1	5
2.	Arsimi dhe të nxënit e të rriturve	O	3+0	5
3.	Praktika pedagogjike II	O	2+2	5
4.	Edukimi inkluziv dhe diversiteti	O	2+1	5
5.	Edukimi për ndërmarrësi	O	3+0	5
6.	1. Trendet bashkëkohore në arsim 2. Edukimi ndërkulturor 3. Teknologjitë e reja dhe mësimi në distancë	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>14+5</b>	<b>30</b>

### SEMESTRI IV

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Arsimi gjatë gjithë jetës dhe zhvillimi profesional	O	3+0	5
2.	Institucionet arsimore si komunitet i punës	O	2+1	5
3.	Teza e masterit	O		20
<b>Gjithsej</b>			<b>5+1</b>	<b>30</b>



#### 4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS

Përshkrimi për secilin kurs	
1	<p><b>Edukimi dhe shoqëria</b></p> <p>Kursi adreson aspektet e ndërlidhjes midis edukimit, shkollimit dhe shoqërisë. Kursi elaboron teoritë kryesore sociologjike dhe lidhjen e tyre me arsimin. Ndër të tjera, kursi adreson lidhjen e teorive të ndryshme si teoria funksionaliste, teoria kritike, teoria institucionale, teoria ndërvepruese, teoria e kapitalit social, etj. Kursi synon të ekspozojë studentët drejt lidhjes së aspekteve teorike me realitetin e shkollës, si dhe ndaj rrymave kryesore që kanë avokuar filozofë dhe sociologë të ndryshëm në periudha të ndryshme.</p>
2	<p><b>Psikologji e edukimit</b></p> <p>Kursi trajton çështjet praktike dhe ato teorike në mësim dhe në të nxënë. Në kurs studentët përqendrohen në sjelljen njerëzore me përqendrim në zhvillim dhe të mësuarit, si rezultat i ndikimeve të brendshme dhe të jashtme të individit. Kursi përmban qasjet më të reja nga fusha e psikologjisë së edukimit për mësimdhënie efektive, si dhe trajton ndihmesën e përmbajtjeve të psikologjisë kognitive për të nxënit si proces intelektual. Po ashtu në kurs trajtohen edhe aspektet intrinzike dhe ekstrinzike për motivimin e subjekteve për të nxënë të suksesshëm. Si edukim ka të bëjë me aplikimin e njohurive në proceset ku të mësuarit ndodh (shkolla dhe mjedise të tjera). Psikologjia e edukimit sqaron zhvillimet kognitive, gjuhësore, personale, sociale dhe morale, të cilat janë relevante për të kuptuar sjelljen e individëve, dallimet në mes të individëve.</p>
3	<p><b>Politikat arsimore dhe legjisllacioni</b></p> <p>Kursi ofron mundësi për studentët të njihen me ciklin e zhvillimit të politikave arsimore, si dhe me politikat aktuale në fuqi, si: dokumente kurrikulare, strategjitë dhe politikat e ndryshme të standardeve të mësimdhënies, licencimi i mësimdhënësve dhe politika të tjera të ngjashme në sistemin arsimor në Kosovë. Kursi, gjithashtu, ofron mundësi për studentët të njihen me dokumentet kryesore legjisllative në sistemin e arsimit në Kosovë si ligjet e arsimit dhe udhëzimet e ndryshme administrative që rregullojnë aspekte të ndryshme të funksionimit të sistemit arsimor në Kosovë. Theks i veçantë i kushtohet legjisllacionit dhe politikave në fushën e AAP-së.</p>
4	<p><b>Teoria e mësimdhënies dhe mësimnxënies</b></p> <p>Ky kurs është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë – të nxënit dhe pjesa e dytë – mësimdhënia. Kursi ofrohet për të promovuar filozofinë dhe strategjinë bashkëkohore</p>

të të nxënit dhe mësimdhënies. Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi themelore përkitazi me të nxënit, teoritë e të nxënit, stilet e të nxënit, konceptet rreth mësimdhënies, strategjive ndërvepruese të mësimdhënies, format e punës mësimore, planifikimi i punës mësimore, etj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teoritë e të nxënit dhe të mësimdhënies dhe të zbatojnë strategji ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat promovojnë të menduarit kritik dhe kreativ. Gjithashtu, studentët do të analizojnë plane të punës mësimore mbi bazën bashkëkohore të mësimdhënies dhe analizës së bërë në praktikën pedagogjike të shkollës kosovare.

#### 5 Metodatat e hulumtimit në arsim

Kursi shqyrton aspektet e përgjithshme teorike dhe metodologjike të të kuptuarit dhe realizimit të një projekti hulumtues në fushën e arsimit. Kursi në njërin anë adreson qasjet dhe orientimet që duhet të zgjedhë hulumtuesi (ontologjia dhe epistemologjia), kurse në anën tjetër adreson aspektet teorike dhe praktike, si: definimi dhe formulimi i problemeve hulumtuese; formulimi i pyetjeve hulumtuese dhe i hipotezave; hartimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave; analiza dhe interpretimi i të dhënave (duke përfshirë përdorimin e programeve të ndryshme softuerike për analizën e të dhënave); raportimi i hulumtimeve. Kursi adreson edhe aspektet të ndryshme të hulumtimeve kualitative dhe kuantitative dhe shtjellon modele të ndryshme të hulumtimeve, si: studime rasti, hulumtime përshkruese, hulumtime etnografike, hulumtime vepruese, hulumtime vlerësuese etj. Në veçanti kursi adreson modalitetet e analizës të të dhënave sasiore përmes përdorimit të programit SPSS si dhe analizën e të dhënave kualitative.

#### 6 Zhvillimi i kurrikulave në AAP

Kursi trajton aspektet e zhvillimit historik të kurrikulës, zhvillimet që ndikojnë në formësimin e kurrikulës, si dhe ndikimin e kurrikulës në vlerat shoqërore, ekonomike dhe politike. Çështjet e tjera që adreson ku kurs janë orientimet dhe parimet bazë në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës. Për më shumë, kursi adreson çështjet specifike të hartimit të kurrikulave në fushën e arsimit profesional, duke ekspozuar studentët ndaj kurrikulave aktuale në fushën e AAP-së dhe analizën e tyre krahas filozofive dhe parimeve të zhvillimit dhe funksionimit të kurrikulave, si dhe duke bërë lidhjen me të kuptuarit e tregut të punës.

#### 7 Vlerësimi në arsim

Kursi shqyrton aspektet dhe praktikatat e vlerësimit që influencojnë cilësinë e mësimdhënies dhe reformën në shkollë në përgjithësi. Në mënyrë më të theksuar, kursi adreson aspektet e planifikimit dhe realizimit të vlerësimit sipas qasjes së bazuar në kompetenca në kuadër të reformës kurrikulare në Kosovë. Kursi adreson edhe aspektet e tjera të vlerësimit, si: natyra dhe qëllimet e vlerësimit, ndërlydhja e

	<p>vlerësimit me mësimdhënien, llojet e vlerësimit. Për më shumë, kursi trajton në hollësi edhe llojet e ndryshme të vlerësimit, si: vlerësimi i vazhdueshëm, vlerësimi për të nxënë (formativ) dhe vlerësimi i të nxënit (përmbledhës) si dy koncepte që formësojnë vlerësimin që i bëjnë mësimdhënësit nxënësve, ndërsa nga aspekti praktik kursi i ekspozon nxënësit ndaj metodave të ndryshme të vlerësimit, si: vlerësimi i bazuar në portofolio, vlerësimi i punimeve të shkruara, testet dhe cilësia e tyre etj. Përveç kësaj, kursi adreson edhe aspektet sistematike të vlerësimit si: vlerësimet e jashtme kombëtare dhe vlerësimi i programeve.</p>
8	<p>Praktika pedagogjike I</p> <p>Shih përshkrimin tek Praktika pedagogjike I dhe II.</p>
9	<p>Strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies</p> <p>Kursi përmban përmbajtje për strategjitë e reja në mësimdhënien bashkëkohore. Në kurs trajtohen aspekte të mësimdhënies efektive, përmbajtje aktuale për të nxënit si proces kognitiv dhe parakushtet që e mundësojnë të nxënit si proces intelektual. Po ashtu në kurs trajtohen edhe teknikat dhe praktikat e reja të domosdoshme për motivimin e subjekteve për të nxënë të suksesshëm. Në kurs do të trajtohen edhe strategjitë dhe qasjet bashkëkohore për punë me nxënës si dhe filozofitë e ndryshme me nxënësin në qendër, si: të nxënit në bashkëpunim, të nxënit ndërveprues, zgjidhja e problemeve dhe të nxënit e bazuar në projekte. Thëks i veçantë i kushtohet mësimi të bazuar në kompetenca, sidomos në fushën e AAP-së.</p>
1. 1	<p>Mjedisi i punës i mësimdhënësit</p> <p>Kursi ofrohet për të promovuar ecuritë e krijimit të klimës së duhur për punë, arritjes së përqendrimit të studentëve dhe angazhimit të vazhdueshëm të tyre në aktivitete punuese. Në kurs trajtohet aspekti i përqendrimit, orientimit të drejtë dhe konkretizimit të roleve dhe aktiviteteve në veprimtaritë që bën mësimdhënësi me pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Në kurs përpunohen, diskutohen e analizohen bashkërisht me studentë aspektet e ndryshme që ndihmojnë krijimin e kulturës për krijimin e mjedisit të favorshëm punues dhe të ruajtjes së tij, si në aspektin fizik, klimatik, higjienik, psikologjik e pedagogjik, në të cilin punohet e mësohet. Kursi adreson aspektet e zhvillimit të kulturës shkollore, duke identifikuar rolet e secilit pjesëtar të shkollës dhe efektet e një kulture përkrahëse në shkollë, duke përfshirë edhe partneritetin dhe bashkëpunimin kolegial. Kursi, gjithashtu, adreson edhe politikat dhe standardet kryesore që rregullojnë punën e mësimdhënësve në përgjithësi dhe punën e mësimdhënësve të arsimit profesional në veçanti, si dhe modalitetet si secili mësimdhënësi mund të ndikojë në influencimin e zhvillimit të shkollës si organizatë dhe përmirësimi të ambientit të nxënies për nxënës.</p>

## 10.2 Kulturë e komunikimit dhe shkathtësitë komunikuese

Kursi ofrohet për të promovuar kulturën komunikuese në arsim dhe për të avancuar shkathtësitë komunikuese. Në kurs do të trajtohet kuptimi i nocionit kulturë komunikimi vështruar nga aspekti teorik dhe praktik. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të komunikimit, të modaliteteve, teknikave dhe ecurive bashkëkohore për komunikim në veprimtarinë arsimore me qëllim të avancimit të shkathtësive themelore intelektuale në mësim, si të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit aktiv me qëllim të zbatimit të suksesshëm të tyre në praktikë. Në kurs ofrohen përmbajtje për modalitetet dhe kërkesat aktuale për komunikim ndërveprues në mësim, duke iu referuar komunikimit autoaksional, koaksional dhe format e ndryshme të komunikimit në grup për qëllime mësimore. Veçmas do të trajtohet aktualiteti dhe zbatimi modalitete të fjalës së folur dhe të fjalës së shkruar, si dhe të modaliteteve aktuale të komunikimit në arsim.

## 11 Edukimi për karrierë dhe planifikimi

Në këtë kurs mundësohet përvetësimi e koncepteve bazë dhe i disa njohurive më të avancuara në fushën e edukimit për karrierë dhe planifikim të zhvillimit profesional. Në kurs trajtohen faktorët relevantë për edukimin për karrierë dhe analizohen hapat për identifikimin, planifikimin, organizimin dhe realizimin e karrierës individuale të individit. Në kurs ofrohen burime të ndryshme të informacioneve për mundësitë dhe format e ndryshme të ngritjes arsimore para shërbimit dhe në shërbim, si dhe hulumtohen mundësitë për realizimin e potencialeve individuale për arsimim në sferat e mundshme. Po ashtu, në kurs do të analizohen konceptet e ndryshme që burojnë nga Korniza Kombëtare e Kualifikimeve dhe konteksti i shkollave profesionale. Kursi trajton edhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm, si familja, rrethi shoqëror dhe ndikues të tjerë të mundshëm, që ndikojnë dhe ndihmojnë në orientimin e individit në përzgjedhjen e drejtimeve të veçanta me perspektivë në karrierën e të rinjve. Kursi ekspozon studentët ndaj konceptit të analizës së tregut të punës dhe, me këtë rast, identifikohen epërsitë dhe rreziqet gjatë orientimit në drejtime të ndryshme.

## 12 Arsimi dhe të nxënit e të rriturve

Kursi ofrohet për të promovuar filozofinë e arsimit dhe të nxënit në kontekst të ndryshimit të vazhdueshëm dhe ngritjes dhe aftësimin të subjekteve të rritur. Në kurs trajtohen aspekti kronologjik- kohor i zhvillimit të shkencës dhe të mendimit andragogjik, kuptimi i “njeriut të rritur” dhe ndryshimet në rrafshin psiko-fiziologjik të njeriut. Në kurs do të përpunohen bashkërisht me studentë përmbajtje të avancuara për teorinë e ndryshme të të nxënit të të rriturve, duke filluar nga teoria transformativë, teoria e resurseve sociale e humane etj. Kursi do të ofrojë informata edhe për aftësimin e vazhdueshëm, për kualifikimin, rikualifikimin, apo për

kualifikimin për profesion të ri në shoqërinë globale si dhe për identifikimin e qasjeve dhe strategjive të planifikimit të mësimdhënies për të rritur.

### 13 Praktika pedagogjike – I dhe II

Qëllimi parësor i komponentit të praktikës pedagogjike është që studentëve të masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për dizajnimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe të klasës. Komponenti i aftësisë praktik të studentëve përfshin edhe reflektimin e studentëve për mësimdhënien gjatë kohës së kaluar në ligjërata dhe në aktivitete mësimore në shërbim (për ata që kanë praktikë në institucionet e AAP-së), si dhe kohën e kaluar në klasa monitoruese të shkollave të përzgjedhura për aftësimin praktik të studentëve.

Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:

1) Mësimi praktik në fakultet ka dy qëllime primare:

- t'u ofrojë studentëve përgatitjen teorike që u duhet për të qenë të suksesshëm në paralelet e shkollave për AAP (Arsimin dhe Aftësimin Profesional),
- t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për akomodim, reflektim dhe diskutim për të mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë.

2) Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës efektivë në shkollat e AAP-së. Kjo përfshin zhvillimin e aftësive për të krijuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies për të menaxhuar suksesshëm situatat e ndryshme mësimore dhe për të planifikuar, organizuar dhe realizuar mësimin sipas kërkesave kurrikulare.

Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit (mësimdhënësve mentorë dhe asistentëve). Ndërsa pjesa e mësimit praktik në shkolla realizohet nën mbikëqyrjen e mësimdhënësit mentor të shkollës, të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit dhe të punësuar në shkollat e AAP-së, të cilët janë të licencuar nga MASHT-i dhe shquhen për profesionalizëm.

Përderisa mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e mësimit praktik në shkolla realizohet nën mbikëqyrjen e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, të punësuar në shkollat e AAP-së, të cilët janë të licencuar dhe të shquhen për profesionalizëm teorik dhe praktik.

Pjesa e parë e mësimi praktik për studentët e këtij programi do të realizohet gjatë muajit dhjetor, para ligjëratave dhe do të zgjasë 2 javë. Gjatë kësaj periudhe do të kombinohet mësimi praktik në fakultet me mësimin praktik në shkolla, duke u bazuar në Doracakun e mësimi praktik të Fakultetit të Edukimit.

Pjesa e dytë e mësimi praktik do të realizohet gjatë muajit prill, krahas ligjëratave dhe do të zgjasë 3 javë. Gjatë kësaj periudhe do të organizohen orë model nga studentët në mësojtore të shkollës pilot, përkatësisht, në punëtoritë e mësimi praktik për lëndët me praktikë profesionale varësisht nga profili arsimor i studentit dhe duke i përfillur praktikat e mësimdhënies bashkëkohore. Monitorimi i punës së studentëve në shkollë do të realizohet edhe përmes incizimit të orëve të zgjedhura, të cilat analizohen bashkë me mbikëqyrësit si dhe shfrytëzohen nga studentët për reflektim. Ecuria e realizimit të aftësimi praktik të studentëve në shkolla, bëhet duke u bazuar në Doracakun e mësimi praktik të Fakultetit të Edukimit.

Gjatë mësimi praktik, studentët do të mbajnë shënimet vijuese:

**Portofolion e studentit** në të cilën vend qendror ka Plani i Zhvillimit Individual, përgatitjet me shkrim të njëjësive mësimore sipas kurrikulës, të gjitha materialet që janë përdorur gjatë realizimit të orëve model. Studentët në portofolio mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, modele, maketa të ndryshme, foto, apo edhe regjistrime të ndryshme), të cilat dëshmojnë dinamikën e punës në grupe, apo rezultate të tjera, të cilat i kanë arritur gjatë praktikës profesionale në shkollë.

**Ditarin e studentit mësimdhënës.** Një ditar të lidhur të të shkruarit reflektiv duke treguar të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënëit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënëit nga përvojat dhe vetëvlerësimi, dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura.

**Ditarin e mbikëqyrësit.** Secili student do të ofrojë një ditar të lidhur në të cilin mësimdhënësi mentor dhe mbikëqyrësit e Universitetit shkruajnë të dhënat e vrojtimet dhe shënimet.

Këto dokumente do të jenë bazë për vlerësimin e studentit.

Kursi ofron njohuri të avancuara për vështirësitë karakteristike në të nxënë dhe në specifikat e edukimit inkluziv. Në këtë lëndë trajtohen tema që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të vështirësive, llojet dhe natyrën e manifestimeve të tyre si dhe sqarimin e filozofisë për inkluzionin, i cili mbështetet në respektimin e të

	<p>drejtave të njeriut/fëmijës dhe të barabarësisë së individit në shoqëri. Në kurs trajtohen format e inkluzionit në vende evropiane, mundësitë e krijimit të një shkolle dhe shoqërie inkluzive, etj. Në kurs ofrohen përmbajtje për zhvillimin e shkathtësive për planifikimin dhe zbatimin e suksesshëm të strategjive, metodave e teknikave bashkëkohore të edukimit inkluziv, të cilat relativizojnë vështirësitë në të nxënë dhe gradualisht shpien në drejtim të krijimit të një klase dhe shkolle inkluzive.</p>
15	<p><b>Edukimi për ndërmarrësi</b></p> <p>Në këtë kurs mundësohet përvetësimi e koncepteve bazë dhe i njohurive të avancuara në fushën e edukimit për aftësitë e nxënësve në ndërmarrësi dhe aktivitete individuale. Kursi realizon aktivitete me studentë lidhur me përgatitjen e planeve individuale dhe zhvillimin e kreativitetit për ndërmarrësi si dhe shtjellohet ndikimi i faktorëve të ndryshëm që nxisin dhe zhvillojnë vetitë dhe kreativitetin e studentëve për ndërmarrësi në jetë. Kursi u ndihmon studentëve në hartimin e planeve të biznesit, apo edhe të planeve për ide të ndryshme të tjera profitprurëse. Projekt-idetë mund të jenë nga ndërmarrësi për ofrimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacioneve dhe shërbimeve të tjera, ndërmarrësi në fushat prodhuese, ndërmarrësi në fushat mjedisore. Analiza të ndryshme të studimit të tipave të individëve (studentëve) qoftë në aspektin social, qoftë në aspektin e aftësive menaxhuese dhe në aspektin e vetive liderë të studentëve.</p>
16.1	<p><b>Trendet bashkëkohore në arsim</b></p> <p>Kursi adreson aspektet aktuale të mësimdhënies bashkëkohore duke u përqendruar veçmas në sistemet e reja mësimore për të nxënëit e suksesshëm. Kursi do të trajtojë trendet e reja, si: deshkollarizimi i arsimit, krijimi i mundësive të barabarta, shoqëria e dijes, etj. Në pjesën e dytë të kursit adresohen: ndryshimi i vazhdueshëm i rolit të mësimdhënësit në shoqërinë post-moderne dhe kohët e globalizimit; decentralizimi i kompetencave të arsimit dhe fuqizimi i shkollës dhe i mësimdhënësit si faktor; ndryshimi i rolit dhe i qëllimit të funksionimit të shkollës; mësimi elektronik dhe në distancë; ndikimi i trendeve integruese evropiane në sistemet e arsimit. Kursi adreson të gjitha temat me fokus të veçantë nga perspektiva e arsimit profesional.</p>
16.2	<p><b>Edukimi ndërkulturor</b></p> <p>Kursi ofron njohuri për diversitetin kulturor në shoqëri të ndryshme dhe format e edukimit ndërkulturor. Në kuadër të këtij kursi trajtohen tema që kanë të bëjnë të kuptuarit e termave: interkulturalizëm, multikulturalizëm, plukulturalizëm e transkulturalizëm dhe përmbajtjen e edukimit kulturor: paqe, zhvillim, bashkëjetesë, qytetari demokratike dhe të drejtat e njeriut. Gjithashtu, ofrohen përmbajtje lidhur me kulturat e ndryshme në shoqëri, për zhvillimin e edukimit ndërkulturor në Evropë,</p>

	<p>qytetarinë dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë individëve pa dallim, për qëllimin dhe dobinë e edukimit ndërkulturor, kontekstet kulturore etj.</p>
16.3	<p><b>Teknologjitë e reja dhe mësimi në distancë</b></p> <p>Kursi ofrohet për të promovuar procesin e njohjes dhe zbatimit të teknologjisë në veprimtarinë arsimore në praktikë. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të teknologjive të reja, duke filluar nga zbulimet e reja softuerike, platformave për të nxënë në distancë si dhe modaliteteve të tjera për të nxënë dhe për të komunikuar në largësi. Kursi ofron modele aktuale të zbatimit të teknologjisë arsimore dhe të komunikimit në sisteme të hapura, gjysmë të hapura dhe në sistemet e mbyllura të zhvillimit profesional formal dhe joformal. Në kurs do të përpunohen përmbajtje të avancuara për dimensionet polivalente të teknologjive të reja multimediale, të arriturat dhe perspektiva e tyre në kushtet e zhvillimit teknik, teknologjik e shkencor. Kursi do të ofrojë informata edhe për aftësimin e vijuesve për identifikimin dhe shfrytëzimin e resurseve që ofron teknologjia arsimore dhe e komunikimit në aspektin e hapjes së perspektivave të reja në shekullin XXI.</p>
17	<p><b>Arsimi gjatë gjithë jetës dhe zhvillimi profesional</b></p> <p>Në pjesën e parë të kursit do të adresohet arsimi gjatë gjithë jetës si filozofi e të nxënësve në shoqërinë bashkëkohore, duke trajtuar historikun e paraqitjes së idesë për arsimin gjatë gjithë jetës, përcaktuesit që e intensifikuan nevojën për masivizimin e idesë për arsimin gjatë gjithë jetës si dhe ideologët që i paraprijnë idesë për arsimin gjatë gjithë jetës. Në vijim do të trajtohen konceptet bazë si dhe modalitetet e arsimit gjatë gjithë jetës në teori dhe praktikë. Në pjesën e dytë trajtohet zhvillimi profesional i mësimdhënësve në përgjithësi dhe në fushën e AAP-së në veçanti. Kursi adreson modele të ndryshme të zhvillimit profesional, si: modeli me bazë në shkollë, modeli i trajnimit të trajnerëve, si dhe fokusohet në cilësitë e zhvillimit profesional efektiv. Më tej, kursi adreson edhe aspektet e mentorimit të mësimdhënësve, si dhe reflektimit (mësimdhënësi reflektiv) si koncepte themelore në zhvillimin profesional të mësimdhënësve e në veçanti në fushën e AAP-së, duke u lidhur me standardet dhe kompetencat e kërkuara në fushën e AAP-së.</p>
18	<p><b>Institucionet arsimore si komunitet i punës</b></p> <p>Kursi ofrohet për të promovuar nevojën e bashkëpunimit ndër-institucional si komunitete, nga të cilat varet suksesi i veprimtarisë arsimore. Qëllim i kursit është që të elaborohet bashkëveprimi ndër-institucional familje, shkollë komunitet, me qëllim të ngritjes së eficiencës në mësim. Në kurs trajtohen modalitetet e shumta të bashkëpunimit, ndarja e aspekteve të ndryshme të të drejtave dhe përgjegjësive, hartimi i planit të ndërhyrjes së përbashkët, varësisht nga situatat dhe nevoja e bashkëpunimit midis shkollave profesionale dhe tregut të punës si dhe krijimi i</p>



rrjeteve bashkëpunuese. Kursi do të ofrojë informata edhe për ecuritë që preferohen të ndërmerren për reduktimin e sjelljeve të papëlqyeshme, për identifikimin e shkaqeve të manifestimit të sjelljeve të dhunshme si dhe rastet mosrespektimit të kodit etik dhe të rregullativës ligjore të paraparë me standardet përkatëse.

19 Teza e masterit

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit.

Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

1. Tema duhet të ketë 15 000 – 20 000 fjalë, në fontin 12, *Times New Roman*.
2. Referencat dhe citimet duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
3. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
4. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
5. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
6. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studentit regjistrohet për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
7. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
8. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.

9. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.

10. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati.

Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës. Ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.